



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 09.09.2025

NR.09/ 2578 /2025

KONTRATË PËR SHËRBIME

Numri i kontratës¹: 659-25-7311-2-2-1/C672 KKHE-25-041-2-2-1

KOMUNA HANI I ELEZIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

N.SH.H. "ARDI", Qendra, Hani i Elezit, 600506630, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër,
janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Transporti ditorë i nxënëseve sipas LOT-eve me numër identifikues: 659-25-7311-2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Transporti ditorë i nxenesve të SHFMU. Ilaz Thaçi, SHFMU. Veli Ballazhi, shkolla profesionale Kacanik-
sipas llojeve

No.	Lot-I-
1	LOT 1 - Transporti Krivenik, Seçishte, Hani i Elezit- Uji Tharte, Kashan dhe anasjelltas

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 12,388.95 €, [Dymbëdhjetë mijë e treqindë e tetëdhjetë e tetë euro /95 cent/ Euro. Kohëzgjatja e kontratës është me afat prej njëmbëdhjetë (11) muaj nga nënshkrimi i saj mes palëve

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka
borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të
paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe
transaksionet që lidhen me thesarin.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	Xhevdet BUSHI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	09/09/2025
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve Burhan Kuka B.I.- N.SH.H. "ARDI"

Emri:	Burhan KUKA
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	09/09/2025
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-25-7311-2-2-1/C672

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Ndëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë sipas nevojës në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Eshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është <u>[09/09/2025]</u> .
	6.4	Data e Përfundimit është <u>[08.08.2026]</u> .
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është <u>[[Hani i Elezit –Krivenik dhe anasjelltas, SHFMU.I.Thaçi" shkolla amë)</u> <u>-Kashan -Hani i Elezit dhe anasjelltas, (SHFMU.I.Thaçi" shkolla amë)</u> <u>-Krivenik –Seçishtë ne paralelen e SHFMU. "Ilaz Thaçi" ne fsh.Seçishtë dhe anasjelltas]</u>
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <u>[Sear Derjani-Shef i sektorit per Arsim]</u>
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është <u>[0.25%]</u> në ditë për shërbim të përfunduar Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është <u>[10%]</u> të çmimit final të kontratës
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% e vlerës së kontratës me afat prej 12 muajave apo 1 vit.
Gjendja e mjeteve motorike		Mjetet e transportit duhet të jenë në gjendje të regullt teknike, dhe gjdo gjë që mund të ndodhë me fajin e OE-se realizuese të shërbimit të transportit bie nën përgjegjësinë e tij sipas ligjeve në fuqi.
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: <u>Pagesa do të bëhet pas realizimit të shërbimit në cilësi dhe sasi i pranueshme për AK-respektivisht menaxherin i kontratës dhe mbyqyrsi i shkolles përkatëse për realizimin të shërbimit, dhe pas pranim të faturës së nga OE.</u> <u>Pagesa do të bëhet brenda afati ligjor, Në rastet specifike kur ka problem me buxhet të ndarë për këtë shërbim –pagesa do të bëhet sapo mjetet të sigurohen alokohen. Pagesa do të bëhet sipas ditëve të shërbimit mujor të transportit të nxënësve –konform kalendarit shkollor të miratuar nga MASHTI-t</u>
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: <u>AK-respektivisht menaxheri-e i kontratës do të kontrollojnë cilësinë e realizimit të shërbimit të transportit të nxënësve dhe për këtë do të hartojnë raport mujor të realizimit të shërbimit në mënyrë që të realizohet edhe pagesa për këtë shërbim]</u>

		<i>[Transporti duhet te realizohet sipas rregullave per transport-Ligjit per qarkullim rrugor te mjeteve te transportit, mjeti i transportit te jete ne gjendje te rregullt teknik dhe i gatshme per qarkullim rrugor, i paisje me leje te qarkullimit te vlefshem.</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>[Me marreveshje ne mes te AK dhe OE, ose Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë ose Ne te kunderten do te pasoj padia ne Gjykatën kompetente (do te llogariten te gjitha demet)]</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Komeriale ne Prishtine/ në pajtim me ligjin ne Kosovë] b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisionit Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].